

### Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në eurozonë ka vazhduar rikuperimin gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2016, përderisa në linjë me pritjet e BQE-së, shkalla e inflacionit ka shënuar rritje graduale. Përmirësimi i kushteve të financimit, si rezultat i politikave ekspansioniste dhe masave jokonvencionale të ndërmarra nga BQE, si dhe përmirësimin të kushteve në tregun e punës dhe çmimeve të ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare kanë ndikuar në rritjen e aktivitetit ekonomik në eurozonë. Përforcimi i kërkesës në eurozonë është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve në Ballkanin Perëndimor, që u karakterizuan me rritje të eksporteve dhe investimeve.

Ngjashëm me eurozonën dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, rritja e aktivitetit ekonomik në Kosovë gjatë vitit 2016 është nxitur kryesisht nga përforcimi i kërkesës së brendshme, gjegjësisht nga rritja e konsumit dhe investimeve. Parashikimet e BQK-së për vitin 2016 sugjerojnë rritje ekonomike prej 3.6 përqind.

Deri në shtator 2016, çmimet në Kosovë kanë qenë relativisht stabile, me një rritje mesatare të IÇK-së prej 0.1 përqind. Megjithatë, në tremujorin e tretë të vitit 2016, është evidentuar një rritje e shkallës së inflacionit prej mesatarisht 0.2 përqind.

Spektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Deri në shtator të vitit 2016, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc pozitiv buxhetor prej rreth 89.1 milionë euro, krahasuar me bilancin pozitiv prej rreth 6.3 milionë euro deri në shtator të vitit 2015.

Bilanci i pagesave në Kosovë shënoi rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në nëntë muajt e parë të vitit 2016, kryesisht si pasojë e rënies së eksportit të mallrave (9.9 përqind) dhe rritjes së importit (6.3 përqind). Gjithashtu, rënia e të ardhurave nga kompensimi i

punëtorëve ndikoi në përkeqësimin e llogarisë rrjedhëse. Në anën tjetër, rritja e eksportit dhe rënia e importit të shërbimeve ndikoi në rritjen e bilancit pozitiv të llogarisë së shërbimeve. Sa i përket llogarisë financiare, investimet e huaja direkte edhe gjatë tremujorit të tretë vazhduan të shënojnë vlera më të ulëta në krahasim me vitin paraprak.

Spektori bankar gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2016 u karakterizua me rritje të aktivitetit kredidhënës (9.6 përqind), si rezultat i përmirësimin të kushteve të kreditimit nga ana e bankave dhe rritjes së kërkesës për kredi. Rritja e kreditimit vazhdon të financohet qëndrueshëm nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat shënuan një rritje vjetore prej 5.0 përqind.

Norma mesatare e interesit në kredi zbriti në 7.5 përqind në shtator 2016, përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 1.0 përqind.

Norma e kredive joperformuese vazhdoi të zvogëlohet edhe gjatë tremujorit të tretë, duke zbritur në 5.1 përqind në shtator 2016, përderisa edhe treguesit tjerë të shëndetit financiar vazhduan të kenë gjendje të kënaqshme.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe segmentet tjera të sistemit financiar, si sektori pensional, sektori i sigurimeve dhe sektori mikrofinanciar. Për sa i përket performancës, vërehet përmirësim më i theksuar te sektori mikrofinanciar, përderisa edhe sektori pensional realizoi kthim pozitiv nga investimet. Në anën tjetër, sektori i sigurimeve gjatë kësaj periudhe shënoi thellim të humbjes.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b>	<b>i</b>
<b>Eurozona dhe Ballkani Perëndimor</b>	<b>04</b>
<b>Ekonomia e Kosovës</b>	<b>06</b>
Sektori Real	06
Regjistri i bizneseve	08
Sektori Fiskal	08
Sektori i Jashtëm	09
Sistemi Financiar	12
Sektori Bankar	12
Sektori Pensional	21
Sektori i Sigurimeve	22
Sektori Mikrofinanciar	23
Tregu i Letrave me Vlerë	26

## GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë	04
Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së	05
Figura 3. Norma e inflacionit	07
Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë	07
Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit	07
Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit	07
Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit	08
Figura 8. Regjistri i bizneseve	08
Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja	08
Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar	10
Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive	10
Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive	11
Figura 13. Remitencat	11
Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte	12
Figura 15. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës	12
Figura 16. Asetet e bankave komerciale	13
Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave	14

Figura 18. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare-----	14
Figura 29. Kreditë sipas sektorëve ekonomik -----	14
Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik -----	15
Figura 21. Kreditë sipas afatit të maturimit -----	15
Figura 22. Depozitat -----	16
Figura 23. Struktura e depozitave -----	16
Figura 24. Struktura e depozitave sipas maturimit -----	16
Figura 25. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	17
Figura 26. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve-----	17
Figura 27. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	17
Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozita -----	18
Figura 29. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje-----	18
Figura 30. Profiti neto i sektorit bankar-----	18
Figura 31. Vlera e të hyrave sipas kategorive -----	19
Figura 32. Vlera e shpenzimeve sipas kategorive dhe rritja vjetore e shpenzimeve -----	19
Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	19
Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar-----	20
Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	20
Figura 36. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës -----	20
Figura 37. Asetet e sektorit pensional -----	21
Figura 38. Investimet e FKPK-së në obligacione qeveritare të Republikës së Kosovës -----	21
Figura 39. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	21
Figura 40. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	21
Figura 41. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	23
Figura 42. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive-----	23
Figura 43. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve -----	24
Figura 44. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar-----	24
Figura 45. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	24
Figura 46. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	25
Figura 47. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	25
Figura 48. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	25
Figura 49. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	25
Figura 50. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	26
Figura 51. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit-----	26
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së -----	05
Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës -----	26
Tabela 3. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	28

**SHKURTESAT:**

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook


### Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Aktiviteti ekonomik në eurozonë ka vazhduar rikuperimin gradual edhe në tremujorin e tretë të vitit 2016, përderisa në linjë me pritjet e BQE-së, shkalla e inflacionit ka shënuar rritje graduale. Ekonomia e eurozonës ka vazhduar të shfaqë qëndrueshmëri ndaj efekteve anësore të ekonomisë globale dhe pasigurive politike, ndihmuar kryesisht nga politikat ekspansioniste dhe masat jokonvencionale të ndërmarra nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior, kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të financimit në eurozonë. Në TM2 2016, rritja vjetore e BPV-së në eurozonë mbeti e pandryshuar nga viti paraprak në 1.6 përqind, rritje e mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme (figura 1). Politikat ekspansioniste dhe masat jokonvencionale të ndërmarra nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të financimit në eurozonë.

Për më tepër, përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve në tregjet e punës dhe çmimet e ulëta të naftës janë përkthyer në rritje të të ardhurave të disponueshme, duke ndikuar kështu në rritjen e konsumit të brendshëm.

Rritja ekonomike në eurozonë në TM3 2016 kundrejt periudhës së njëjtë në vitin paraprak u mbështet kryesisht nga ekonomitë qendrore të eurozonës si Gjermania (1.7 përqind), Franca (1.1 përqind), Italia (0.9 përqind) dhe veçanërisht Spanja (3.2 përqind).

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë



Burimi: Eurostat (2016)


Norma e inflacionit në eurozonë vazhdoi të jetë nën objektivin e BQE-së. Në TM3, shkalla mesatare e inflacionit ishte 0.3 përqind.

Masat e reja të ndërmarra nga BQE-ja në mars 2016 në kuadër të programit të lehtësimit sasior kishin si qëllim parësor evitimin e deflacionit dhe rikthimin e shkallës së inflacionit më afër caktut prej 2 përqind. Megjithatë, ndikimi i politikave ekspansioniste monetare në nivelin e çmimeve në eurozonë ka rezultuar të jetë i kufizuar, kryesisht si pasojë e rënies së theksuar të çmimeve të energjisë gjatë vitit 2016. Projeksionet e BQE-së për vitin 2016, të publikuara në muajin shtator, sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë pritet të jetë 0.2 përqind.

Lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i vitit 2016 ka ndikuar drejtpërdrejtë në rënieën e mëturjeshe të normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor (figura 2). Gjithashtu, BQE-ja ka vazhduar të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit në zero përqind.

Rikuperimi i aktivitetit kreditues në eurozonë ka vazhduar edhe në tremujorin e tretë të vitit 2016, i mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës për kredi dhe përmirësimi i kushteve të kreditimit veçanërisht për ekonomitë familjare. Standarde të lehtësuara kreditore gjatë TM3 2016 raportoi veçanërisht Gjermania, përderisa përmirësim të kushteve të kreditimit si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare raportuan Gjermania, Franca, Italia dhe Holanda. Rritja mesatare e kreditimit në eurozonë në TM3 2016 ishte rreth 1.8 përqind, ku me rritje më të shpejtë prej 2.1 përqind u karakterizuan ekonomitë familjare, përderisa kreditë për ndërmarrjet shënuan rritje prej 1.4 përqind. Rritja e të ardhurave të disponueshme në eurozonë në këtë periudhë mund të kenë ndikuar në depozitat e rezidentëve në sektorin bankar në vendet e eurozonës. Rritje më të lartë të depozitave në këtë periudhë shënuan ndërmarrjet (6.9 përqind në TM3 2016), pasuar nga depozitat e ekonomive familjare (3.7 përqind).

Figure 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së



Burimi: Euribor (2016) dhe BQE (2016)

Gjatë TM3 2016, performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor vazhdoi të përforcohet.

Rritja kërkesës në eurozonë, si partner kryesor tregtar për vendet në Ballkanin Perëndimor, u përkthye në përmirësim të pozicionit të neto eksporteve të rajonit. Rritja e eksporteve, së bashku me rritjen e investimeve, paraqitën kontribues të rëndësishëm në rritjen mesatare prej 2.5 përqind të BPV-së në Ballkanin Perëndimor në TM2 2016. Për vitin 2016, parashikimet e FMN-së sugjerojnë për një normë mesatare të rritjes vjetore të BPV-së prej 3.3 përqind (tabela 1).

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016
Bosnja dhe Hercegovina	2.4	1.1	3.2	3.0
Kosova	3.4	1.2	4.0	3.6
Mali i Zi	3.5	1.8	3.2	5.1
Maqedonia	2.9	3.5	3.7	2.2
Serbia	2.6	-1.8	0.7	2.5
Shqipëria	1.0	1.8	2.8	3.4

Burimi: WEO (2016) dhe vlerësimi i BQK-së për Kosovën gjatë vitit 2016.

Ngjashëm me eurozonën, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, që kryesisht i atribuohen zhvillimeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Në TM2 2016, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, dhe Maqedonia u përballën me deflacion (-1.5, -1.0, përkatësisht -0.3 përqind), përderisa Serbia dhe Shqipëria regjistruan një shkallë mesatare të inflacionit prej 1.2 përkatësisht 1.9 përqind.

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar të vendeve të rajonit, me rritje të aktivitetit kreditues në këtë periudhë u karakterizua veçanërisht Serbia (9.5 përqind) dhe Kosova (8.4 përqind), përderisa rënie të kreditimit shënoi Kroacia dhe Mali i Zi (5.8

përkatësisht 0.2 përqind). Vendet e Ballkanit Perëndimor raportuan edhe për rritje të depozitave. Mali i Zi shënoi rritjen më të lartë të depozitave deri në qershor 2016 (9.3 përqind), përderisa rritjen më të ulët shënoi Shqipëria (2.1 përqind).

Deri në shtator, euro është zhvlerësuar kundrejt valutave tjera të mëdha si dollari, sterlina britanike dhe franku zviceran. Gjatë kësaj periudhe, norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan është zhvlerësuar për 0.3 përqind, frankës zvicerane dhe sterlinës britanike për 3.1 përkatësisht 9.2 përqind. Zhvlerësimi i euros kryesisht i është atribuuar ndikimit të zgjerimit të masave ekspansioniste në kuadër të programit të gjerë stimulues të ndërmarr nga BQE-ja. Në kuadër të monedhave të rajonit, euro është vlerësuar kundrejt denarit maqedon dhe dinarit serb për 0.1 përkatësisht 1.9 përqind, përderisa është zhvlerësuar ndaj lekut shqiptar për 1.7 përqind.

## Ekonomia e Kosovës

### Sektori real

Ekonomia e Kosovës në vitin 2016, sipas parashikimeve të BQK-së, pritet të shënojë rritje prej rreth 3.6 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e BPV-së.


Vlerësimet e ASK-së sugjerojnë rritje të aktivitetit ekonomik prej 3.6 përqind deri në shtator të vitit 2016, rritje kjo e gjeneruar kryesisht nga rritja e investimeve prej 9.2 përqind si dhe rritja e konsumit prej 4.8 përqind. Në këtë periudhë, neto eksportet

vlerësohet të jenë karakterizuar me thellim të konsiderueshëm të deficitit prej 13.0 përqind në terma real. Rritja reale e ekonomisë së Kosovës është mbështetur kryesisht nga rritja në aktivitetin e sektorit të tregtisë (4.4 përqind), transportit (4.0 përqind) dhe ndërtimitarisë (1.5 përqind). Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë shënuar tek afarizmi me pasuri të patundshme (4.0 përqind), administrimi publik (1.4 përqind) dhe industria përpunuese (1.2 përqind).

### Çmimet

Deri në shtator 2016, çmimet në Kosovë kanë qenë relativisht stabile, me një rritje mesatare të IÇK-së prej 0.1 përqind. Në shtator 2016, IÇK u karakterizua me një rritje prej 0.5 përqind (figura 3).

Figura 3. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2016)

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, deri në shtator 2016, me rritje u karakterizuan çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (9.1 përqind), pasuar nga çmimet e shërbimeve shëndetësore (3.0 përqind). Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar te shërbimet e transportit si dhe rrymës, gazit e lëndëve tjera djegëse (me nga 3.3 përqind respektivisht). Me rënie prej 0.9 përqind u karakterizuan edhe çmimet e

ushqimit, që përfaqësojnë rreth 33.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar (figura 4).


Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Indeksi i çmimeve të importit deri në shtator 2016 shënoi rënie vjetore prej 3.7 përqind (figura 5).


Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2016)

Çmimet e produkteve minerale, të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit, shënuan rënien më të lartë (17.1 përqind), ndërsa çmimet e vajrave ushqyese shënuan rritjen më të lartë të çmimeve (8.2 përqind) (figura 6).


Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Deri në shtator 2016, indeksi i çmimeve të prodhimit u karakterizua me rënie prej 3.8 përqind. Në këtë periudhë, me rënie u karakterizuan çmimet e energjisë elektrike, prodhimit të produkteve minerale dhe nxjerrjes së xehes së metalit. Ndërsa, me rritje të çmimeve u karakterizuan prodhimi i lëkurës si dhe prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve (figura 7).

Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2016)



## Regjistri i bizneseve

Sa i përket regjistrimit të bizneseve, deri në shtator 2016 është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe po ashtu rritje e numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 8,173 apo 820 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak, ndërsa në të njëjtën periudhë, u mbyllën 1,841 ndërmarrje apo 606 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak (figura 8).

Figura 8. Regjistri i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2016)

Numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 2,151 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i prodhimit me 935 ndërmarrje, bujqësisë me 856 ndërmarrje dhe hotelerisë me 807 ndërmarrje (figura 9).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pothuajse në të gjithë sektorët është shënuar rritje e ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e bujqësisë është shënuar rritja më e lartë e ndërmarrjeve të regjistruara prej 181 ndërmarrje më shumë, pasuar nga sektori i prodhimit që u karakterizua me 159 ndërmarrje më shumë.

Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2016)

## Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore<sup>1</sup> deri në shtator 2016 arritën vlerën neto prej 1.20 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.0 përqind. Shpenzimet buxhetore<sup>2</sup> arritën vlerën prej 1.11 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 7.0 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc pozitiv buxhetor prej rreth 89.1 milionë euro krahasuar me bilancin pozitiv prej rreth 6.3 milionë euro deri në shtator të vitit 2015.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje e lartë e të hyrave kufitare por edhe të hyrave nga tatimet e brendshme. Të hyrat kufitare arritën vlerën neto prej 768.0 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 14.0 përqind, ndërsa të hyrat nga tatimet e brendshme arritën vlerën neto prej 270.9 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 21.0 përqind.

<sup>1</sup> Në kuadër të të hyrave primare nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>2</sup> Në kuadër të shpenzimeve primare nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pagesat nga depozitat në mirëbesim.

Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 180.2 milionë euro (20 përqind rritje), pasuar nga të hyrat tatimore indirekte të cilat arritën vlerën prej 905.9 milionë euro (15 përqind rritje) dhe të hyrat jo-tatimore të cilat arritën vlerën prej 127.2 milionë euro (1.1 përqind rritje).

Sa i përket shpenzimeve, pothuajse të gjitha kategoritë u karakterizuan me rritje përveç mallrave dhe shërbimeve të cilat shënuan rënie. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje prej 4 përqind dhe arritën vlerën prej 407.1 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu shënuan rritje për 10 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 320.7 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 21.3 përqind të gjithë shpenzimeve, shënuan rritjen më të lartë, prej 11 përqind dhe arritën vlerën prej 235.9 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale), shënuan rënie për 1.0 përqind dhe arritën vlerën prej 129.4 milionë euro.

Borxhi publik, në shtator 2016, ka arritur në 842.1 milionë euro që është për 17.0 përqind më i lartë krahasuar me shtator 2015. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në rreth 14.3 përqind nga 12.5 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm prej 34.5 përqind (i cili ka arritur në 473.6 milionë euro), ndërkohë që borxhi i jashtëm publik ka shënuar një ngritje të lehtë prej 0.3 përqind duke arritur në 368.4 milionë euro. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithë borxhin e brendshëm është zvogëluar në


43.8 përqind nga 51.0 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

### Sektori i Jashtëm

Deri në shtator të vitit 2016, deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 323.2 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 208.5 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarive të të ardhurave parësore dhe dytësore. Në anën tjetër, bilanci pozitiv në llogarinë e shërbimeve shënoi rritje.

Deficiti në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 8.7 përqind deri në shtator të vitit 2016, si pasojë e rënies së eksporteve dhe rritjes së importeve. Eksporti i mallrave deri në shtator të vitit 2016 kishte vlerën prej 225.9 milionë euro, që përkon me një rënie vjetore prej 9.9 përqind (rritje prej 5.6 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2015) (figura 10).<sup>3</sup>

Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro




Burimi: ASK (2016)

<sup>3</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Rënia e vlerës së eksportit të mallrave gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rënies së eksporteve të metaleve bazë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit (rreth 37.6 përqind) (figura 11).

Rënia e vlerës së gjithsej eksporteve të metaleve bazë u zvogëlua kryesisht si pasojë e rënies së prodhimit të nikelit në ekonominë e vendit, si dhe rënies së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe. Me rënie u karakterizuan edhe eksportet e tekstilit dhe artikujve të tekstilit, si dhe eksportet e makinerive dhe pajisjeve elektrike. Në anën tjetër, eksportet e produkteve minerale shënuan rritje, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së eksportit të energjisë elektrike. Gjithashtu, eksportet e produkteve të plastikës dhe gomës, si dhe eksportet e drurit dhe produkteve të drurit shënuan rritje në periudhën raportuese.

Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2016)

Vlera e gjithsej mallrave të importuara deri në shtator të vitit 2016 arriti në 2.0 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.3 përqind. Në kuadër të importit të mallrave, me rritje u karakterizua importi i makinerive dhe pajisjeve elektrike, importi i

mjeteve të transportit, importi i produkteve të plastikës dhe gomës, importi i metaleve bazë, si dhe importi i produkteve ushqimore. Në anën tjetër, importi i produkteve minerale shënoi rënie të konsiderueshme (figura 12). Rënia e vlerës së eksporteve dhe rritja e vlerës së mallrave të importuara rezultoi në zvogëlim të shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte në 11.1 përqind deri në shtator të vitit 2016 (13.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar).

Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2016)


Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 526.8 milionë euro deri në shtator të vitit 2016, një rritje kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak prej 20.1 përqind. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara në këtë periudhë shënoi rritje vjetore prej 8.6 përqind, duke arritur në 904.3 milionë euro. Në të njëjtën periudhë, vlera e importit të shërbimeve shënoi rënie prej 4.2 përqind dhe arriti në 377.5 milionë euro. Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet e transportit u karakterizuan me rritje vjetore prej 12.2 përkatësisht 13.8 përqind, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit shënoi rënie prej 17.9 përqind. Sa i përket importit të

shërbimeve, shërbimet e transportit shënuan rënie prej 17.8 përqind ndërsa shërbimet e udhëtimit shënuan rritje prej 9.8 përqind.

Deri në shtator të vitit 2016, llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rënie prej 43.6 përqind. Përderisa bilanci i të ardhurave nga kompenzimi i punonjësve<sup>4</sup> u zvogëlua për 8.0 përqind, bilanci i të ardhurave të realizuara nga investimet shënoi rritje për 15.5 përqind.

Bilanci i të ardhurave dytësore u zvogëlua për 0.3 përqind deri në shtator të vitit 2016, zvogëlim që kryesisht i atribuohet nivelit më të ulët donacioneve dhe granteve të ndryshme, por edhe reduktimit të shpenzimeve nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, deri në shtator të vitit 2016 shënuan vlerën prej 504.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.2 përqind (figura 13).


Figura 13. Remitencat, në milionë euro



Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 35.1 përqind përkatësisht 24.0 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 6.6 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë, deri në shtator të vitit 2016, arritën vlerën prej 182.3 milionë euro, që paraqet nivel më të ulët krahasuar me vlerën prej 268.5 milionë euro të regjistruar në periudhën e njëjtë të vitit 2015. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me zvogëlim të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondin e investimeve në aksione, si dhe investimet në instrumentet e borxhit (figura 14).

Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 84.0 përqind të gjithsej IHD-ve, shënoi vlerën prej 153.1 milionë euro që është për 15.5 përqind më i ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 29.2 milionë euro, një zvogëlim kundrejt vitit paraprak


<sup>4</sup> Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendren e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

prej 66.6 përqind. Rënia e IHD-ve u evidentua veçanërisht në sektorin e patundshmërive dhe në sektorin e shërbimeve financiare, sektor që u karakterizuan me rënie vjetore prej 16.6 përkatësisht 82.2 përqind.

### Sistemi Financiar

**Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 5.22 miliardë euro në shtator 2016, që përkon me një rritje vjetore prej 9.3 përqind (figura 15). Rritja e aktivitetit të sistemit financiar në vend kryesisht i atribuohet rritjes së asetëve të sektorit bankar dhe sektorit pensional, si sektorët me pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej asetet e sistemit financiar në vend.**

Figura 15. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës




Vlera e asetëve të jashtme neto (AJN) të sistemit financiar të Kosovës në shtator 2016 ishte 2.68 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.0 përqind. Sektori mikrofinanciar vazhdoi të jetë i vetmi me bilanc negativ të AJN-ve, si rezultat i mbështetjes së lartë të financimit të aktivitetit nga burime të jashtme.

### Sektori Bankar

#### **Asetet**

**Asetet e sektorit bankar regjistruan rritje të qëndrueshme prej 5.8 përqind në shtator 2016, duke arritur në 3.51 miliardë euro (figura 16). Zgjerimi i portofolios së kredive ishte kontribuuesi më i madh në rritjen e asetëve të sektorit bankar. Rritja e aktivitetit të sektorit bankar reflekton ecurinë e qëndrueshme të rritjes së depozitave, si një burim i rëndësishëm financimi për aktivitetin kreditues në vend.**

Figura 16. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

**Në shtator të vitit 2016, stoku i letrave me vlerë të sektorit bankar u karakterizua me ngadalësim të rritjes në 1.3 përqind nga 15.5 përqind një vit më parë. Ngadalësimi ishte pasojë e zvogëlimit të investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës (11.3 përqind), përderisa investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja dhe investimet në letrat me vlerë në kategorinë 'tjera' shënuan rritje (13.7 përqind dhe 5.5 përqind respektivisht). Rënia e investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës është rezultat i rritjes së konkurrencës nga akterët e tjerë të tregut si fondet**


pensionale, kompanitë e sigurimeve, institucionet e tjera publike, të cilët kanë rritur shumën e investuar në letra me vlerë të Kosovës. Po ashtu, ecuria në këtë kategori të asetëve mund t'i atribuohet edhe rritjes së mjeteve të dedikuara për kreditim, duke marrë parasysh kërkesën në rritje për kredi, normën e ulët të kredive joperformuese si dhe kthimin më të lartë nga investimi në kredi.

**Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në regjistruan rënie prej 3.6 përqind dhe 2.5 përqind respektivisht.** Rënia e kësaj kategorie pjesërisht mund të jetë ndikuar nga zhvendosja e mjeteve drejt rritjes së kreditimit. Për më tepër, rënia në bilancin me BQK-në është ndikuar nga masa e ndërmarrë nga BQK në gusht të vitit 2016 për ngarkimin me normë negative të interesit për rezervat e bankave mbi nivelin e rezervës së detyrueshme.

### Kreditë

**Kreditë e sektorit bankar përshpejtuan rritjen vjetore në 9.6 përqind** (figura 17). Vlera e gjithsej kredive në shtator 2016 arriti në 2.18 miliard euro. Rritja e kreditimit gjatë vitit 2016 kryesisht i atribuohet rritjes së kërkesës për kredi, si dhe përmirësimit të ofertës së kreditimit nga sektori bankar përmes uljes së normës së interesit, rritjes së shumës së kredisë së aprovuar dhe uljes së tarifave tjera të jo-interesit.


Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

**Kategoria me rritjen më të madhe të kredive ishte kategoria e ekonomive familjare duke paraqitur kështu edhe kontribuuesin kryesor në rritjen e gjithsej kredive të sektorit bankar** (figura 18). Në kuadër të kredive të reja ndaj ekonomive familjare, kreditë konsumuese u karakterizuan me rritje prej 20.6 përqind, pasuar nga rritja prej 6.1 përqind e kredive hipotekare, përderisa kreditë me kushte favorizuese shënuan rënie prej 8.0 përqind.

Figura 18. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2016)

**Për dallim nga kreditë për ekonomitë familjare të cilat përshpejtuan ritmin e rritjes, kreditë për ndërmarrjet shënuan rritje më të**



**ngadalësuar vjetore.** Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike vazhdon të mbetet e dominuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë, pasuar nga ato për prodhimtari dhe ndërtimtari (figura 19). Sidoqoftë, rënia vjetore e kredive për tregti ndikoi që kjo kategori të zvogëloj pjesëmarrjen në krahasim me vitin paraprak, ndërsa kategoritë tjera, në veçanti kategoria e shërbimeve tjera, rritën pjesëmarrjen.

Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (Shtator 2016)




Burimi: BQK (2016)

**Deri në shtator 2016, kreditimi i të gjithë sektorëve shënoi rritje, përjashtuar atë të tregtisë dhe të prodhimit që u karakterizuan me rënie (0.2 përqind dhe 3.4 përqind përkatësisht)** (figura 20). Vlen të veçohet rritja e kreditimit të ndërtimtarisë pas tre vite rënie. Ky zhvillim mund të shpjegohet nga rritja e vlerës së shtuar në aktivitetin ekonomik nga sektori i ndërtimtarisë i evidentuar përmes BPV-së për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2016 të publikuar nga ASK.

Kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve shënuan rënie vjetore prej 18.5 përqind, ku kategoria e kredive investuese regjistroi rënie prej 29.2 përqind, ndërsa kreditë e reja jo investuese regjistruan rritje vjetore

prej 1.3 përqind. Kjo kryesisht reflekton rënien e kredive të reja ndaj sektorit të shërbimeve (24.6 përqind) dhe të industrisë (26.2 përqind), të cilët përbëjnë pjesën më të madhe të kredive të reja ndaj ndërmarrjeve.


Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2016)

**Struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë afatmesme, më konkretisht nga kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’.** Megjithatë, kreditë me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ dhe ‘mbi 10 vite’ kanë vazhduar trendin rritës (figura 21).

Figura 21. Kreditë sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

*Gjatë TM3 2016, përshpejtimi i aktiviteti kreditues iu atribuua kryesisht rritjes më të shpejtë të kredive të ekonomive familjare. Struktura e kredive sipas sektorëve ekonomik ka mbetur e ngjashme me tremujorët paraprak, përderisa struktura e kredive sipas afatit të maturimit ka shfaqur tendencë të rritjes së kredive me afat më të gjatë maturimi.*

### Detyrimet dhe Burimet Vetanake


Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë 79.4 përqind të gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake, duke përfaqësuar kështu burimin kryesor të financimit të aktivitetit të sektori bankar. Pjesë përbërëse shumë të rëndësishme të kategorisë së detyrimeve vazhdojnë të mbesin edhe kategoria e ‘obligimeve tjera’ dhe ‘bilanci me bankat komerciale’.

Kategoria e burimeve vetanake të sektorit bankar u karakterizua me rritje vjetore prej 13.5 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së theksuar të vlerës së fitimit të mbajtur në 68.7 milionë euro (24.4 milionë në shtator 2015).

### Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës vazhdojnë të shënojnë rritje, megjithëse me një ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhat paraprake. Në shtator 2016, depozitat arritën në 2.79 miliard euro, që paraqet një rritje prej 5.0 përqind (figura 22). Ky ngadalësim u ndikua nga rënia e depozitave në kategoritë e depozitave të kursimit dhe të afatizuara (7.0 dhe 1.6 përqind përkatësisht).


Figura 22. Depozitat, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat regjistruan një normë vjetore të rritjes prej 5.8 përqind. Depozitat e ekonomive familjare vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej depozitave, pasuar nga depozitat e ndërmarrjeve (figura 23).

Figura 23. Struktura e depozitave, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Në të njëjtën periudhë, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore prej 5.1 përqind. Kjo rritje është ndikuar nga rritja e normës mesatare të interesit në depozitat për ndërmarrjet.



Figura 24. Struktura depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)


**Depozitat e transferueshme vazhduan të rrisin pjesëmarrjen në gjithsej depozitat,** gjë që reflekton nivelin relativisht të ulët të normave të interesit në depozita. Në shtator 2016, pjesëmarrja e tyre në gjithsej depozitat e sektorit bankar të Kosovës arriti në 58.1 përqind (figura 24).

*Depozitat vazhduan të rriten megjithëse me ritëm më të ngadalësuar. Struktura e depozitave vazhdoi të ndryshojë në favor të depozitave të transferueshme, përderisa depozitat e afatizuara dhe ato të kursimit zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej depozitat.*

### Normat e Interesit

**Dallimi në mes të normës mesatare të interesit në kredi dhe asaj në depozita u ngushtua në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.** Norma mesatare e interesit në kredi në shtator 2016 u zvogëlua në 7.5 përqind përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 1.0 përqind (figura 25).

Figura 25. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2016)

### Normat e interesit në kredi

**Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u zvogëlua në 6.9 përqind nga 7.5 përqind sa ishte në shtator 2015 (figura 26).** Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, normat e interesit në kreditë investuese dhe jo-investuese vazhdojnë të përcjellin trend rënës, por rënia ishte më e theksuar në kreditë jo-investuese (1.1 pikë përqindje).

Figura 26. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve




Burimi: BQK (2016)

Në shtator 2016, vërehet rënie më e lehtë e normave të interesit në kreditë për ndërmarrjet për dallim nga periudhat paraprake. Normat e interesit në sektorë të

ndryshëm ekonomik qëndruan në një nivel relativisht të ngjashëm ndaj njëra tjetrës. Ky përafrim vjen kryesisht si rezultat i rënies më të theksuar të normave të interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë dhe ‘sektorëve tjerë’, të cilët kishin norma më të larta interesi, përderisa sektori i industrisë dhe i shërbimeve përcjellën trend rënës më të ngadalësuar (figura 27).

Figura 27. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2016)

**Kreditë për ekonomitë familjare gjithashtu u karakterizuan me rënie të normës mesatare të interesit, e cila zbriti në 8.0 përqind.** Në kuadër të kredive për ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese dhe për ato hipotekare vazhduan të ndjekin trend rënës.

### Normat e interesit në depozita

Rritja e normës mesatare të interesit në gjithsej depozitat kryesisht reflekton rritjen e normës së interesit në depozitat ndaj ndërmarrjeve, përderisa norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare mbeti në nivel të ngjashëm me atë të vitit paraprak (figura 28).


Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2016)

**Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve arriti në 1.3 përqind, një rritje vjetore prej 0.7 pikë përqindje.** Më specifikisht, rritje shënuan normat e interesit në depozitat e afatizuara të ndërmarrjeve (figura 29).

Figura 29. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive




Burimi: BQK (2016)

**Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare mbeti e ngjashme me vitin paraprak në 0.9 përqind.** Rrjedhimisht, ndryshimet në kuadër të normave të interesit në depozitat e kësaj kategorie, sipas llojit të depozitave (të afatizuara, kursimeve apo transferueshme) nuk kanë qenë domethënëse.

### Performanca e sektorit bankar<sup>6</sup>

Profiti i sektorit bankar shënoi rënie krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i rënies së të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve të sektorit. Vlera e profitit të realizuar deri në shtator 2016 ishte 61.3 milionë euro, që në krahasim me vitin paraprak i cili shënoi profitin më të lartë në historikun e sektorit bankar, paraqet rënie prej 11.6 përqind (figura 30).


Figura 30. Profiti neto i sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Të hyrat e sektorit bankar vazhdojnë të ndjekin trend rënës. Në shtator 2016, ato shënuan rënie vjetore prej 2.2 përqind, dhe zbritën vlerën në 175.2 milionë euro. Rënia e të hyrave kryesisht i atribuohet rënies së të hyrave nga interesi si pasojë e zvogëlimit të normës mesatare të interesit në kredi (figura 31).


Figura 31. Vlera e të hyrave sipas kategorive, rritja vjetore



Burimi: BQK (2016)

Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 114.0 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 3.7 përqind. Në rritjen e gjithsej shpenzimeve, kontributin kryesor e kishte rritja e shpenzimeve të jo interesit (figura 32).

Figura 32. Vlera e shpenzimeve sipas kategorive dhe rritja vjetore e shpenzimeve




Burimi: BQK (2016)

Më konkretisht, gjatë kësaj periudhe rritjen më të lartë e shënuan nënkategoria e shpenzimeve të provizioneve për humbjet e mundshme në kredi. Rritja e theksuar e kreditimit si dhe rritja e kredive të shlyera gjatë kësaj periudhe, mund të ketë shtyrë bankat që të ndajnë vlerë më të lartë të provizioneve për humbjet e mundshme në kredi në mënyrë që të

<sup>6</sup> Bazuar në të dhënat e paaudituar.

mbajnë në nivel të lartë raportin e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione.


Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit është përkeqësuar në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, si pasojë e rënies së të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve në këtë periudhë (figura 33).

Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



\*Për 2016 treguesit e profitabilitetit janë llogaritur duke u bazuar në performancën deri në shtator 2016

Burimi: BQK (2016)


Treguesit e profitabilitetit kanë shënuar rënie si rezultat i rënies së profitit. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) u zvogëluan në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke e ndërprerë

kështu trendin rritës që kishin shënuar gjatë tri viteve të kaluara (figura 34).

### Treguesit e shëndetit financiar

Deri në shtator 2016, sektori bankar regjistroi rënie të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione.

Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve




Burimi: BQK (2016)

Pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë e sektorit u zvogëlua në 5.1 përqind si rezultat i rënies vjetore prej 18.7 përqind të vlerës së kredive joperformuese, si dhe përsheptimit të rritjes së gjithsej kredive (figura 35). Kjo ndihmoi edhe në rritjen e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione, e cila u rrit në 122.1 përqind.

Sektori vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit që qëndroi në 18.3 përqind në shtator 2016. Treguesi i likuiditetit shënoi rënie në krahasim me vitin paraprak, si pasojë e zbatimit të normës negative të interesit në rezervat e mbajtura nga bankat komerciale në BQK mbi rezervën e detyrueshme, e që rrjedhimisht ndikoi në zvogëlimin e vlerës së pasasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në

gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, sektori bankar vazhdon të shfaqë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit (figura 36).

Figura 36. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës



Burimi: BQK (2016)


Deri në shtator të vitit 2016 sektori bankar shënoi rënie të profitit si pasojë e zvogëlimit të të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve. Cilësia e portofolit kreditor shënoi përmirësim të mëtutjeshëm, duke arritur normën më të ulët të kredive joperformuese të regjistruar në vitet e fundit. Për më tepër, sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizmit dhe pozicion të kënaqshëm të likuiditetit.

### Sektori pensional

Sektori pensional, i cili renditet i dyti për nga pjesëmarrja e aseteve në gjithsej sistemin financiar në Kosovë, shënoi rritje vjetore të theksuar të aseteve prej 19.0 përqind. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional në shtator 2016 arriti në 1.39 miliard euro (figura 37).

Rritja e theksuar e aseteve të këtij sektori është rezultat i rritjes së kontributeve të reja dhe rritjes së kthimit në investime.

Figura 37. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Deri në shtator 2016, vlera e arkëtimit të reja arriti në 113.6 milionë euro (101.7 në shtator 2015). Vlera e arkëtimit të reja të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-së) arriti në 113.3 milionë euro, ndërsa ajo e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensionave (FSKP-së) arriti në 359.4 mijë euro.

Sektori pensional realizoi kthim pozitiv në investime prej 56.2 milionë euro, për dallim nga kthimi prej 12.1 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. FKPK realizoi kthim pozitiv në investime prej 55.8 milionë euro, ndërsa FSKP 447.0 mijë euro. Për kundër faktit që tregjet u karakterizuan me lëkundje të theksuara këtë vit, duket se strategjia investuese e FKPK-së (që përbën 99.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit) ka dhënë fryte duke amortizuar luhatjet dhe duke siguruar rritje të vlerës së kthimit.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) vazhdon t'i rrisë investimet e tij në Obligacione Qeveritare të Republikës së Kosovës. Këto investime shënuan rritje vjetore prej 47.4 përqind në shtator 2016.

Figura 38. Investimet e FKPK-së në Obligacione Qeveritare të Republikës së Kosovës (milionë euro)




Burimi: FKPK (2016)

*Sektori pensional në shtator 2016 shënoi rritje vjetore të theksuar të aseteve. Kthimi pozitiv në investime si dhe rritja e kontributeve të reja ishin dy faktorët kryesorë që ndikuan në këtë rritje. FKPK vazhdoi të rrisë vlerën e investimeve në Obligacione Qeveritare të Republikës së Kosovës.*

### Sektori i sigurimeve<sup>6</sup>

Sektori i sigurimeve, që përfaqëson rreth 3.2 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, në shtator 2016 shënoi rritje vjetore prej 5.7 përqind (figura 39).

Figura 39. Asetet e sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK (2016)

Sigurimet jo-jetë përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit (90.4 përqind të gjithsej aseteve të sektorit), dhe shënuan rritje vjetore prej 5.5 përqind. Pjesa e mbetur e aseteve përbëhet nga sigurimet jetë, asetet e të cilave shënuan rritje vjetore prej 7.7 përqind.

Vlera e gjithsej primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve deri në shtator 2016 ishte 3.0 përqind më e lartë se në vitin paraprak. Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jo-jetë të cilat përfaqësojnë 97.0 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e tyre gjatë kësaj periudhe ishte 62.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.3 përqind. Ndërsa, pjesa e mbetur e primeve të shkruara përbëhet nga primet e sigurimit jetë të cilat arritën vlerën 1.9 milionë euro (rënie vjetore prej 3.5 përqind).

Dëmet e paguara, ku përfshihen dëmet e kompanive të sigurimit dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rënie të lehtë vjetore prej 0.4 përqind (rritje prej 13.4 përqind deri në TM3 2015).

Figura 40. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2016)

<sup>6</sup> Vlerat e fundit në dispozicion për sektorin e sigurimeve janë me Qershor 2016.

Zvogëlimi i vlerës së dëmeve të paguara krahas rritjes së primeve të shkruara, rezultoi në rënie të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara (figura 40).

## Performanca e sektorit të sigurimeve

**Sektori i sigurimeve vazhdoi të regjistrojë humbje, e cila është thelluar dukshëm krahasuar me vitin paraprak.** Të hyrat neto të sektorit të sigurimeve deri në shtator 2016 shënuan rënie vjetore prej 0.6 përqind, ndërsa shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 16.0 përqind. Si rrjedhojë e kësaj, humbja e regjistruar nga sektori i sigurimeve gjatë kësaj periudhe ishte 12.1 milionë euro (humbje prej 3.1 milionë deri në shtator 2015).<sup>7</sup> Thellimi i humbjes ishte rrjedhojë e humbjes së shënuar në kuadër të sigurimit 'jo-jetë' (humbje prej 12.4 milionë euro), përderisa performanca financiare e sigurimit 'jetë' ishte pozitive (fitim në vlerë prej 265.9 mijë euro). Humbjet e sigurimit 'jo-jetë' kryesisht i atribuohen rritjes së shpenzimeve për provizionet teknike si pasojë e rivlerësimit të tyre gjatë gjysmës së parë të vitit.

**Rënia vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 10.7 përqind, dhe rritja prej 23.2 përqind e rezervave teknike të sektorit të sigurimeve ndikuan në përkeqësimin e nivelit të likuiditetit.** Rritja e theksuar e rezervave teknike ishte si rezultat i rivlerësimit të tyre, pasuar nga kërkesa e auditorëve të jashtëm. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 78.2 përqind në shtator 2016

(107.9 në shtator 2015), përderisa raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëlua në 70.2 përqind (93.3 në shtator 2015). Rritja e theksuar e investimeve në letrat me vlerë ka ndikuar në rënien e parasë së gatshme dhe ekuivalentët e saj.


*Sektori i sigurimeve deri në shtator 2016 shënoi rritje të primeve shkruara, kurse vlera e dëmeve të paguara shënoi rënie të lehtë. Megjithatë, performanca financiare e këtij sektori vazhdoi të jetë e brishtë, duke u karakterizuar me thellim të humbjes krahasuar me vitin paraprak si pasojë e shpenzimeve të rritura.*

## Sektori mikrofinanciar

### Asetet

**Sektori mikrofinanciar në TM3 2016 shënoi rritje vjetore të theksuar të aseteve prej 19.1 përqind (figura 41).**

Figura 41. Asetet e sektorit mikrofinanciar (milionë euro)



Burimi: BQK (2016)

Njëri prej kontribuuesve kryesorë të rritjes ishte rritja e kredive bruto, e cila kryesisht financohet nga huamarrjet në sektorin e jashtëm, të cilat u rritën për

<sup>7</sup> Bazuar në të dhënat e paaudituar.




23.3 përqind. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar vazhdon të dominohet nga kreditë bruto (73.2 përqind), pasuar nga lizingjet (15.8 përqind) dhe asetet tjera (11.0 përqind).

### Kreditë

Deri në shtator 2016, vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar shënoi rritje të theksuar vjetore prej 29.7 përqind (figura 38).


Figura 42. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive



Burimi: BQK (2016)

Kontributin më të madh në rritjen e kredive të lëshuara nga sektori mikrofinanciar e kishte kategoria e kredive ndaj ekonomive familjare. Kjo kategori përfaqëson 67.4 përqind të gjithsej kredive të sektorit, si dhe shënoi rritje vjetore prej 33.4 përqind. Gjithashtu, edhe kreditë ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 32.6 përqind të gjithsej kredive të sektorit, dhe që shënuan rritje vjetore prej 22.5 përqind, kontribuan dukshëm në rritjen e gjithsej kredive.

Figura 43. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2016)

Sa i përket kredive të lëshuara ndaj sektorëve ekonomik, industria shënoi rritjen vjetore më të lartë, pasuar nga bujqësia dhe tregtia. Ndërtimtaria është i vetmi sektor i cili shënoi ngadalësim të rritjes (figura 43).

### Lizingjet

Lizingjet vazhdojnë të jenë kategoria e dytë për nga pesha (15.8 përqind) në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar (figura 44).

Figura 44. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar (përqindje)



Burimi: BQK (2016)


Kjo kategori shënoi rënie vjetore të lehtë prej 0.6 përqind, krahasuar me rënien vjetore prej 2.6 përqind në shtator 2015.



### Normat e Interesit


Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar në shtator 2016 vazhdoi të përcjellë trendin rënës, duke rënë në 22.3 përqind. Ishte norma e interesit për kreditë ndaj ndërmarrjeve që ndikoi dukshëm në rënien e normës mesatare të interesit në këtë sektor (figura 45).

Figura 45. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i industrisë rezultoi të ketë normën më të ulët të interesit në kredi.

Figura 46. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë normën më të lartë të interesit në kredi, por që megjithatë vazhdon të renditet i dyti për nga rritja e kreditimit (figura 46).

### Performanca e sektorit mikrofinanciar

Deri në shtator 2016, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 3.2 milionë euro, që shënon një rritje vjetore prej 52.5 përqind. Kontribuues kryesor në këtë rritje ishte rritja më e madhe e të hyrave (kryesisht e atyre nga interesi) krahasuar me shpenzimet (figura 47).


Figura 47. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Rritja e profitit të realizuar deri në shtator 2016 ndikoi në përmirësimin e treguesve të profitabilitetit (figura 48).

Sektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me nivel të ulët të kredive joperformuese prej 3.8 përqind, nivel ky më i ulëti në vitet e fundit.


Figura 48. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



\*Për vitin 2016 profiti është analizuar me performancën deri në Shtator 2016  
Burimi: BQK (2016)

Për më tepër, sektori mikrofinanciar u karakterizua edhe me nivel të kënaqshëm të mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizioneve prej 169.8 përqind (figura 49).

Figura 49. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



Burimi: BQK (2016)

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me përshejtim të theksuar të rritjes së asetëve deri në shtator 2016. Gjithsej kreditë vazhduan të shënojnë rritje, përderisa norma mesatare e interesit përcjelli trendin rënës. Profiti i këtij sektori u rrit dukshëm, dhe cilësia e portofolit kreditor vazhdoi të përmirësohet.

### Tregu i letrave me vlerë

Deri në shtator 2016, numri i ankandeve për emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës arriti në 15 në shtator 2016, sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave. Vlera e shpallur në ankande ishte 375.0 milionë euro.

Deri në shtator 2016, Qeveria e Kosovës ka shpallur vlerë më të vogël të bonove të thesarit krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak. Ndërsa, ka shpallur numër më të madh të fletë-obligacioneve, krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak (tabela 2). Sa i përket shumës së emetuar, ajo mbeti e njëjte me vlerën e shpallur si për bono të thesarit ashtu edhe për fletë-obligacione.

Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës


Periudha	Numri i bonove të thesarit	Vlera e shpallur bonove të thesarit	Numri i fletëobligacioneve	Vlera e shpallur e fletëobligacioneve
Janar-Shtator 2013	16	238	-	-
Janar-Shtator 2014	13	265.17	3	37
Janar-Shtator 2015	11	213.6	5	84.95
Janar-Shtator 2016	9	195	6	140

Burimi: MF (2016)

Sipas afatit të maturimit, struktura e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të tregojë tendencë të zhvendosjes nga letrat me vlerë me maturitet afatshkurtër, në letra me vlerë me maturitet afatgjatë.

Kategoria kryesore në strukturën e letrave me vlerë vazhdon të mbetet ajo e bonove të thesarit me afat maturimi 364 ditë, pasuar nga fletë obligacionet me afat maturimi dy vite (figura 50).


Figura 50. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Shuma e ofertuar nga pjesëmarrësit tejkaloi shumë të shpallur në ankandë nga Ministria e Financave për 2.23 herë (1.48 në shtator 2016). Këtë vit shihet të ketë rritje të ofertës dhe njëkohësisht edhe rritje të emetimit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës krahasuar me shtator 2015.

Figura 51. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Në qershor 2016, norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ka shënuar rënie në 0.91 përqind (2.0 përqind në qershor 2015). Në këtë periudhë, normat e interesit për të gjitha afatet e maturimit ishin më të ulëta krahasuar me shtator 2015.

### **Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2016): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 16 TM3 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

### **Referencat:**

BQK (2016):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2016):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2016): Metal Prices database.

FAOUN (2016): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2016): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2016): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Shtator 2015	Shtator 2016
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	-0.6%	0.1%
Çmimet (fondi i periudhës)	-1.2%	0.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	1,045.1	1,198.9
Shpenzimet (në milionë euro)	1,038.7	1,109.8
Bilanci (në milionë euro)	6.3	89.1
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	4,771.2	5,213.6
prej të cilave: Bankat	3,321.4	3,512.7
Kredi	1,993.3	2,184.4
Depozita	2,656.5	2,789.5
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	7.9	7.5
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	0.9	1.0
Hendeku i normës së interesit	7.0	6.5
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-208.5	-323.2
prej të cilave: remitencat e pranuar	493.8	504.5
Llogaria financiare	-186.5	-32.1
Investimet e huaj direkte në Kosovë	268.5	182.3
Investimet portfolio, net	54.1	259.7
Investimet tjera, net	-94.9	-204.1
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, net	20.8	72.6
Asetet	4,363.6	4,697.7
Detyrimet	4,342.8	4,625.2
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1,919.7	2,014.2
Borxhi i jashtëm privat	1,482.9	1,575.6
Borxhi i jashtëm publik	436.8	438.6

Burimi:

1/ ASK (2016).

2/ MF (2016).

3/ BQK (2016).

